



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA LIGJORE

Fushveprimtaria e Zyrës

- Merr pjesë në përgatitjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve
- Pranon propozim vendimet dhe materialet tjera nga Drejtoritë - si propozues të këtyre materialeve para se të kalojnë për shqyrtim dhe diskutim në Kuvend dhe komitete
- Ofron ndihmë profesionale për Kryesuesin e Kuvendit, këshilltarët dhe komitetet
- Mbanë dhe përgatitë procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve
- Përpilon tekstet e spastruara të akteve të aprovuara në mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve
- Ofron ndihmë profesionale për shërbimet dhe komisionet në kuadër të Administratës së Komunës sa i përket hartimit të akteve juridike
- Ofron ndihmë profesionale në hartimin e akteve të përgjithshme juridike
- Kujdeset për përputhshmërinë e akteve normative të Komunës me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë
- Jep këshilla, rekomandime, udhëzime dhe opinione/mendime sipas kërkesave të shërbimeve të Administratës komunale
- Bashkëpunon dhe koordinon me institucionet qendrore në funksion të ndërtimit të infrastrukturës ligjore për fushat nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Komunës
- Harton marrëveshje, vendime, urdhëresa dhe materiale të ndryshme të kërkuara nga Kryetari i Komunës
- Kryen edhe punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë së Administratës.

Raport i punës për periudhën janar-qershor 2023

- Për periudhën raportuese, Zyra ligjore ka përgatitur, trajtuar, proceduar/shpërndarë, azhurnuar dhe publikuar materiale dhe akte juridike të ndryshme për Kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive dhe shërbimet tjera të administratës së Komunës varësisht kërkesave të paraqitura në kuadër të autorizimeve ligjore.

Vendime të Kryetarit të Komunës	104
Urdhëresa	0
Autorizime	9
Shkresa dhe Kërkesa të ndryshme të komunikimit zyrtar të kryetarit të Komunës me institucione të nivelit qendror	15
Konsultime, dhënie e këshillave dhe mendimeve (Kryetarit të Komunës, drejtorëve të Drejtorive, zyrtarëve dhe shërbime tjera të Komunës), përfshirë edhe hartimin e modeleve të akteve të ndryshme	permanente
Përgatitja dhe procedimi për publikim i vendimeve dhe akteve tjera të natyrës së përgjithshme të Kryetarit të Komunës (të nxjerra në muajt janar-qershor 2023)	110
Ftesa për takim publik me qytetarë dhe njoftime për dëgjime publike	2
Procesverbal nga takimi publik me qytetarë	0



-Mbledhje të Kuvendit të Komunës.....	9
-Mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa.....	4
-Mbledhja e Komitetit për Komunitete (përgatitja dhe procedim i thirrjes).....	6
-Mbledhje e Komitetit për Barazi Gjinore.....	2
-Mbledhje e Komitetit për Zhvillim Ekonomik.....	0
-Mbledhje e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	1
-Mbledhje e KKSBB-së	2

Propozim vendime të Kuvendit të Komunës	29
Propozim rregullorë – pjesëmarrje në propozimin final	0
Hartim i procesverbaleve të Kuvendit të Komunës dhe trupave të Kuvendit	16
Shkresa të Kryesuesit të Kuvendit, për Ministrinë e Pushtetit Lokal	5
Procedim i akteve të Kuvendit në MPL	26
Hartimi dhe spastrimi i tekstit të akteve të Kuvendit	43
Përgatitje e listave për kompensimin / (KPF & KK dhe komiteteve tjera)	5
Vërtetime të Kryesuesit për anëtarë të Kuvendit	11
Përgatitje dhe procedim i dokumentacionit për zëvendësimin e një anëtareje të Kuvendit të Komunës (anëtares së dorëhequr, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit.	0
Raportim në MPL rreth akteve të kuvendit të Komunës që kanë të bëjnë me rishqyrtimin e ligjshmërisë për periudhën janar – qershor(gjysma e muajit qershor) 2023	3
Publikime të akteve të Kuvendit të Komunës në uebfaqen e Komunës dhe Gazetën Zyrtare dhe përcjellja e tyre Drejtorive përkatëse	Vendime 35

- Gjithashtu zyrtarët e Zyrës ligjore janë të caktuar në disa komisione dhe grupe punuese dhe detyra të cilat kërkojnë mjaft angazhim dhe përkushtim sa i përket mbledhjes së të dhënave, shqyrtimit të dokumentacioneve, kërkesave / ankesave etj, të ngjashme, ndër të më të rëndësishmet:
 - Qasja në dokumente publike.....19 kërkesa
 - Parandalimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesit.....0 lëndë
 - Komisioni për ankesa për nëpunësit e administrativo teknik dhe mbështetës.....0 ankesa
 - Përgatitja e dokumentacionit dhe pjesëmarrja në punën e Komisionit në terren për formimin e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane(Një zyrtar në katër procese gjatë muajit qershor 2023)
 - Komisioni për shitjen e banesave në pronësi të Komunës

- Vlen të ceket se, në baza periodike, në Zyrën ligjore arrijnë kërkesa dhe pyetësorë për raportime të ndryshme nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe institucioneve tjera qendrore që ndërlidhen me funksionimin e organeve komunale, kërkesa për të cilat kërkohet angazhim për grumbullimin e të dhënave dhe dhënien e përgjigjeve përkatëse.

Nr. prot. 02-401/04-0044259/23
 Podujevë, datë 30.06.2023

Zyra Ligjore
 Sabedin Namani 
 Enis Sheholli 
 Osman Bajrami 